



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Në dy procedura të prokurimit, "Ndërtimi i QKMF në Istog" me vlerë të kontratës 2,364,143€ dhe "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar në repartin e pediatriisë në Mitrovicë -Lot 2", me vlerë të kontratës 45,625€, kishte mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë prezantimi i saktë i llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet shmangies së vonesave në ekzekutimin e pagesave, evitimit të mangësive në fushën e prokurimit si dhe shpalosjes së detyrimeve kontigjente.

Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në procesin e prokurimit

Gjetja

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë. Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur favorizimin. Sipas nenit 25.7 të Rregullores nr. 001/2022, OE duhet të dorëzojnë dokumente që vërtetojnë përshtatshmërinë profesionale sipas nenit 66 të LPP. Sipas Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, neni 10, njësia kërkuese përgatit ose propozon detyrën projektuese, specifikimet teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), paramasat dhe paralogaritë, duke siguruar që janë në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të kësaj rregulloreje.

Në procedurën e prokurimit "Ndërtimi i QKMF në Istog" me vlerë të kontratës 2,364,143€, Ministria e Shëndetësisë në Dosjen e Tenderit, përkatësisht te paramasa dhe paralogaria ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë emra të brendeve të caktuara. Po ashtu, OE fitues kishte paraqitur kontratë të menaxherit të projektit të nënshkruar nga i njëjti person në rolin e punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Tutje në procedurën e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar në repartin e pediatriisë në Mitrovicë -Lot 2", me vlerë të kontratës 45,625€, janë evidentuar se disa produkte me përshkrim të njëjtë teknik janë paraqitur si pozicione të ndara me emërtime të ndryshme. Si rezultat, është nënshkruar dhe realizuar kontrata me çmime të ndryshme për produktin e njëjtë.

Këto parregullësi janë rezultat i neglizhencës së personave përgjegjës gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike në procesin e inicimit të procedurës së prokurimit.

Ndikimi

Kjo përbën një kufizim të mundshëm të konkurrencës duke favorizuar produkte të caktuara dhe duke penguar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomik me produkte të ngjashme si dhe në pranimin e ofertës me çmime të ndryshme për të njëjtin produkt.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A2 - Pasaktësi në prezantimin e informatave

Gjetja

Rregullorja Nr. 01/2017 Për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore - Neni 6, përcakton se Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informacionet financiare dhe informacionet tjera jofinanciare. Sipas Neni 16, Raport për të arkëtueshmet, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Më tej Neni 19, obligon organizatat buxhetore të raportojnë vlerën e pasurive jofinanciare, përfshirë stoqet.

LLogaritë e arkëtueshme në MSH ishin mbivlerësuar për shkak se në regjistrat e Inspektoratit Shëndetësor ishte prezantuar një gjobë prej 10,000€, edhe pse lënda ishte e përfunduar dhe OE nuk kishte ndonjë obligim ndaj MSH-së.

Po ashtu, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, është evidentuar një mbivlerësim i stoqeve në vlerën 5,008 € si rezultat i dyfishimit të stokut.

Ndërsa në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, nuk ishte e mundur konstatimi i gjenjdes reale të stokut për shkak të mungesës së dëshmive bindëse. Gjatë testimit janë ofruara dokumente të ndryshme financiare gjë që e ka pamundësuar vlerësimin e gjendjes së prezantuar në PVF.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur gjatë përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare.

Ndikimi

Prezantimi jo i sakta i të dhënave në PVF ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e tyre të mos informohen drejtë lidhur me shpalosjen e tyre.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj kontrole më të forta në përgatitjen e të dhënave në PVF, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2024, ishte 4,853,684€.

Çështja A3 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente

Gjetja	<p>Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 37 - "Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara", Paragrafi 84 - Për çdo klasë të provizionit, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për: (a) vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës.</p> <p>Paragrafi 86 - Përveçse kur mundësia e një daljeje burimesh për shlyerje është e pakët, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për secilën klasë të detyrimit të kushtëzuar në fund të periudhës së raportimit, për një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit të kushtëzuar dhe, kur është e mundur: (a) një vlerësim të efektit të tij financiar të përcaktuar në paragrafët 36-52.</p> <p>Organizata buxhetore, në dokumentet e saj burimore, ka paraqitur se nga 701 detyrime totale kontigjente, të cilat janë kryesisht të natyrës së njëjtë, 21% e tyre (ose 150 detyrime kontigjente) nuk kanë një vlerë financiare të përcaktuar.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët, të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontigjente, si dhe mos koordinimit të duhur dhe qartësisht ndërmjet përfaqësuesit (zyrës ligjore) dhe zyrës së financave.</p>
Ndikimi	<p>Prezantimi i detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon në informimin e drejtë dhe saktë të palëve të interesit apo shfrytëzuesve të PFV-ve lidhur me shpalljen e këtyre detyrimeve, po ashtu në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.</p>
Rekomandimi A3	<p>Ministri duhet të ndërmarrë masa për të vlerësuar me saktësi mundësitë e realizimit të detyrimeve kontigjente dhe për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme, për të ofruar një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	80,395,329	69,030,812	57,306,037	45,490,623	35,744,066
Grante Qeveritare - Buxheti	71,525,329	58,787,690	51,952,940	38,955,720	28,893,431
Financimi përmes huamarrjes	1,020,000	1,020,000	312,772	1,113,828	4,614,822
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	7,850,000	7,850,000	4,470,916	4,782,498	1,625,114
Donacionet vendore	0	538,863	399,867	129,150	0
Donacionet e jashtme	0	834,258	169,541	509,427	610,700

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 11,387,981€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore.

Në vitin 2024 MSH ka shpenzuar 83% të buxhetit final ose 57,306,037€ me një rritje prej 26% në krahasim me vitin 2023.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	80,395,329	69,030,812	57,306,037	45,490,623	35,744,066
Pagat dhe mëditjet	14,575,078	16,259,048	16,218,601	13,031,527	10,776,522
Mallrat dhe shërbimet	29,445,598	30,365,272	27,006,275	19,452,122	17,970,476
Komunalitë	281,848	288,848	231,299	219,052	182,602
Subvencionet dhe transferet	3,613,805	3,613,805	3,369,272	4,978,161	3,778,897
Investimet Kapitale	32,479,000	18,503,839	10,480,590	7,809,761	3,035,569

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,660,942€, rritje kjo si rezultat i ndryshimit të ligjit të pagave për zyrtar publik . Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 919,238€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 89%.
- Buxheti final për komunal, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 7,000€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 80%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Realizimi i kësaj kategorie ishte 93%.
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 13,975,161€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit. Nga 33 projektet e planifikuara, 10 nga këto nuk kishin fare progres financiar. Realizimi i kësaj kategorie ishte 57%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Ministria e Shëndetësisë në 2024 ishin në vlerë 7,637,563€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga inspektorati, licenca nga aktivitetet individuale dhe të lira, licenca për produkte medicinale, banderolat, participimet, shtija e shërbimeve dhe inspektimi higjienik sanitar. Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, të hyrat e arkëtuara derdhen në buxhetin e Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	6,827,214	6,827,214	7,653,203	6,128,450	5,842,047
Të hyrat jo tatimore	6,827,214	6,827,214	7,637,563	6,127,404	5,836,038
Të hyrat tjera	0	0	15,640	1,046	6,009

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të MSH-së ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime. MSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, të gjashtë (6) rekomandimet janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.	Gjatë testimit të mostrave nuk janë hasur raste të tilla për regjistrim të pasurive.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri, duhet të sigurojë një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar

3.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet që janë në proces të ndërtimit duhet të mbesin në regjistrat e pasurive si investime në vijim te Organizata financuese deri në finalizimin e tyre me qëllim që vlera e pasurive të jetë e plotë në PFV.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet përmes stafit përgjegjës që para se të realizohet pagesa, të verifikohet nëse vlera e garancionit bankar është plotësisht në përputhje me kërkesën.	Në mostrat e testuara nuk kemi hasur raste ku vlera e garancionit bankar nuk ishte në përputhje me kërkesat.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që të gjitha pasuritë e blera për organizatat tjera përfituese të cilat janë të përfunduara bazuar në raportet e pranimi teknik të barten tek përfituesit përmes një procedure të shkruar dhe një koordinimi të mirë me të gjithë akterët relevant.	Testimet nuk kanë hasur raste të tilla. Gjatë testimit të mostrave pasuritë e blera për organizatat tjera përfituese zyrtari i pasurisë kishte bërë kërkesë me shkrim që pasuritë në fjalë të regjistrohen në organizatat përfituese.	I zbatuar
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Mnistri duhet të sigurojë përmes burimeve njerëzore definimin e qartë të obligimeve të secilit specializant në kontratat e tyre të punës. Po ashtu, departamenti i financave duhet të lëshoj një dokument (faturë, fletëpagesë) në lidhje me obligimin që ka specializanti në përputhje me tarifën në udhëzim.	Gjatë vitit 2024 MSH kishte lëshuar fatura për llogaritë e arkëtueshme të specializantëve.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit




Burbuqe Idrizi Ukaj, Udhëheqëse e ekipit



Drilon Osmani, Anëtar i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DITËPUNIM: 02/06/2025			
NIP: 03			
Kodi i Klasifikimit: 47862			
Nr. Protokollit: 1			
Nr. i faqeve: 1			



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org.	Nr. Prot.	05-4462	
Org. Jedinica	Rvoj Prot.		
Org Unit	Prot. No.		
Nr. i faqeve	Date:	02/06/2025	
Biruarica	Datum:		
No. pages		-1-	
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2024 - (në tekstin e mëtejshëm "DRAFT-RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2024");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dr. Naim Bardhi

Sekretar i përgjithshëm

Data: 02.06.2025

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Aplikimi i kritereve diskriminuese për shkak të përdorimit të këtyre markave: "003 Elektro", Seksioni 2.3, Pozicionet 1 dhe 2 - referenca ndaj markës SONY; • "004 Makineria", Seksioni 3, Pozicioni 1 - referenca ndaj markës Samsung; • "004 Makineria", Seksioni 4, Pozicioni 1 - referenca ndaj markës Samsung; • "004 Makineria", Seksioni 5 - referenca ndaj Fabrikës së prodhimit të radiatorëve në Gjilan; • "004 Makineria", Seksioni 8, Pozicioni 13 - referenca ndaj markës Siemens. Ndërsa për këto produkte: Karrige, Tavolina për kryeinfermiere, Vitrinë, Varëse rrobash, Fioka, Orman produkte këto me përshkrim të njëjtë në pozicione të ndara
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.